

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-075/15

**Prishtinë,
1 Shkurt 2017**

Në çështjen juridike të:

R. R.

Pala ankuese

Kundër

N/A

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA42194), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 1 Shkurt 2017 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e R. R. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014, për sa i takon kërkesës së regjistruar me numrin KPA42194, refuzohet si e pabazuar
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, i datës 13 mars 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA42194.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 29 gusht 2007, R. R. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) duke vepruar në emër të babait të tij të ndjerë R. R., ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) ku kërkonte vërtetimin e të Drejtës së Pronësisë mbi tri ngastrat kadastrale me numrat 132, 133 dhe 138 me kulturë, livadh dhe me një sipërfaqe të përgjithshme prej 01.46.12 ha, ngastrat kadastrale ndodhen në vendin e quajtur “Ravnice”, fshati Vragovac në Komunën e Pejës (në tekstin e mëtejme: pronat e kërkuara).
2. Për të mbështetur kërkesën, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së dokumentet vijuese:
 - Vendimin nr. 318/54, të lëshuar nga Sekretariati për Ekonomi i Këshillit Popullor për Qarkun e Pejës, të datës 3 qershor 1954. Sipas këtij vendimi, ngastrat kadastrale nr. 133/1 dhe 138/1 i ishin ndarë pronarit të mëhershëm R. R. në shfrytëzim të përkohshëm dhe pa ndonjë pagesë.
 - Vendimin nr. 1891/55 të lëshuar nga Këshilli Popullor, Sekretariati për Ekonomi i Qarkut të Pejës më 26 shkurt 1955. Subjekti i vendimit ishte dorëzimi i pronës në shfrytëzim të përhershëm për Kooperativën Bujqësore në Poçestë. Prona (numri i ngastrës kadastrale nuk është specifikuar) e ish pronarit R.R, me sipërfaqe prej 2.18.71 ha ishte shpronësuar dhe dorëzuar në shfrytëzim të përhershëm për Kooperativën Bujqësore në Poçestë.
 - Certifikatën e lindjes nr. 141/1934, e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil e Komunës së Pejës më 22 gusht 1976, që dëshmon lidhjen familjare në mes të palës ankuese dhe R. R.

- Vendimin nr. 08-463/28 të Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Riposedimin e Pronës të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Pejës më 24 shkurt 1992. Sipas vendimit, e drejta pronësore e R. R. është vërtetuar mbi ngastrat kadastrale nr.132, 133 dhe 138 që më parë janë shpronësuar, prandaj, poseduesi i pronave ishte obliguar t'i dorëzonte R. R. pronat e lartë-përmendura brenda afatit prej 8 ditësh pas plotfuqishmërisë së vendimit.
 - Certifikatën e vdekjes nr. 203-7-24/07-03 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil e Komunës Arandëlovac më 21 mars 2007, që dëshmon se R. R. kishte vdekur më 12 korrik 1994 në vendin e quajtur Banja, Komuna e Arandëlovac.
 - Autorizimin nr. 31844/2011 të vërtetuar në Gjykatën e Parë Themelore të Komunës së Beogradit më 11 mars 2011. Sipas këtij autorizimi, R. R. e autorizon Z. R. për ta përfaqësuar atë pranë Agjencisë Kadastrale të Republikës së Kosovës për regjistrimin e pronës që ishte konfiskuar në vitin 1953 për shkak të Reformës Agrarare dhe kthimin e saj te R. R. në bazë të vendimit nr. 08-463/28. Dokumentet që kanë të bëjnë me pronën mund të gjinden në kërkesën KPA42194.
 - Konstatimin nr. 15-463-6520 të lëshuar nga Komuna e Pejës, Drejtorati për Kadastër dhe Çështje Pronësore, të datës 26 tetor 2011, me të cilin kërkesa nr. 15-463-6520/11 e datës 16 shtator 2011 për regjistrimin e vendimit nr. 08-463/28, të datës 24 shkurt 1992, për kryerjen e korrigjimit në Drejtoratin për Kadastër të Komunës së Pejës në emër të R. R., ishte refuzuar për shkak të mungesës së bazës ligjore për një kërkesë të tillë.
 - Ankesën e paraqitur kundër Konstatimit nr. 15-463-6520 të lëshuar nga Komuna e Pejës, Drejtorati për Çështje Pronësore, për shkak të shkeljeve të rënda të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa ishte paraqitur nga Z. R. pranë Kuvendit Komunal të Pejës, Drejtoratit për Çështje Pronësore më 28 shkurt 2012.
3. Me datën 28 maj 2010, AKP-ja kishte bërë identifikimin e pronave të kërkuara duke publikuar kërkesën në Gazetën Njoftuese të AKP-së nr. 1 dhe në Buletinin e Zyrës për Pronë të UNHCR-it. Gazeta ishte lënë në hyrje dhe në dalje të fshatit Vragoc,

dhe në Zyrën Kadastrale të Komunës së Pejës. Saktësia e njoftimit ishte vërtetuar më 21 qershor 2010.

4. Kërkesa mbetet e pa-kontestuar sepse askush nuk ka shprehur interesim të marrë pjesë në procedurën në lidhje me pronën e kërkuar, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me dispozitat e nenit 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079.
5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka verifikuar pozitivisht **vetëm** vendimin nr. 08-463/28 të lëshuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Ri-posedimin e Pronës, të datës 24 shkurt 1992, ndërsa Departamenti i Kadastrit i Komunës së Pejës ka pohuar se pronat e kërkuara ishin gjetur se ishin të nënndara në numra të ri (132/2, 133/1 dhe 138/2) dhe të regjistruara si Pronë Shoqërore në emër të “Kooperativa Bujqësore”.
6. Nga provat në dosjen e lëndës vërehet se pala ankuese ishte kontaktuar nga AKP-ja përmes telefonit dhe se ai e kishte vërtetuar se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar kishte ndodhur në vitin 1955 (faqe 091 të dosjes së lëndës).
7. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin e tij KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014, kishte vendosur se kërkesa duhej të hidhej poshtë për shkak se binte jashtë juridiksionit të KKPK-së për shkak se paraqitësi i kërkesës nuk e kishte dëshmuar se kërkesa e tij përfshinte rrethanat që drejtpërdrejtë kishin të bënin me konfliktin e viteve 1998-1999 apo rezultonin nga ai.
8. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 17 tetor 2014. Ai ka paraqitur ankesë më 13 nëntor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese thekson se KKPK-ja ka vërtetuar faktet materiale në mënyrë jo të plotë dhe ka bërë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
10. Pala ankuese ka theksuar se pohimi i KKPK-së se bazuar në deklaratën e palës ankuese humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar ka ndodhur në vitin 1954, nuk është i vërtetë. Ai ka deklaruar se ai asnjëherë nuk i ka dhënë askujt asnjë deklaratë dhe as nuk i ka dorëzuar asnjë dokument për sa i përket çështjes së përmendur në vendimin e KKPK-së. Pala ankuese kishte kërkuar që t'i ofrohej dokumenti në të cilin ai kishte deklaruar ashtu, nëse ai dokument ekziston.

11. Pala ankuese konstaton se kërkesa e dorëzuar në AKP nuk ishte kontestuar, që do të thotë se ajo nuk ishte kundërshtuar nga askush; prandaj, nuk ka prova kundërshtuese për të kundërshtuar kërkesën e tij.
12. Në ankesë, ajo jep një prezantim detaj të dokumenteve që ajo ka dorëzuar për të vërtetuar të Drejtën Pronësore të saj dhe kërkon që Gjykata Supreme të miratoj ankesën e saj dhe të merr një vendim të ri me të cilin do të vërtetonte të Drejtën e saj Pronësore.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

13. Gjykata Supreme shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejme: LPK), dhe pas vlerësimit të deklarimeve ankimore gjeti se:
Ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjin nr. 03/L-079, i cili thekson se pala mund të paraqes ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita kur palët informohen për vendimin.

Meritat e ankesës

14. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi ankesën në përputhje me dispozitat e nenit 194 të LPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se ankesa është e pabazuar.
15. KKPK-ja e mbështeti vendimin e saj mbi faktin se pala ankuese nuk e ka dëshmuar se kërkesa e tij ka të bëjë me rrethanat që drejtpërdrejtë ndërlidhen me konfliktin e viteve 1998-1999 apo rezultojnë nga ai.
16. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër të Komisionit për ririposelimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën e paluajtshme por edhe se ai nuk është tani në gjendje të ushtroi të drejtat e

- tilla pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
17. Siç mund të shihet në dosjen e lëndës, pala ankuese supozohet të jetë kontaktuar me telefon nga AKP-ja dhe me sa duket ai e ka pohuar se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar kishte ndodhur në vitin 1955. Neni 99 paragrafi 1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore thekson se kërkesa, përgjigja në kërkesë, ankesat dhe deklaratat e tjera, kërkesat dhe propozimet që i adresohen gjykatës duhet të parashtrohen me shkrim. Kushti për formën e shkruar gjithashtu përmbushet kur parashtresat dërgohen përmes telegrafit, faksit apo postës elektronike në rast se ceket dërguesi.
 18. Në dosjen e lëndës nuk ekzistojnë provat që dëshmojnë se pala ankuese ka dorëzuar deklaratë me shkrim ku deklaron se humbja e posedimit ka ndodhur në vitin 1954. Biseda telefonike nuk mund të konsiderohet si parashtresë përmbajtja e së cilës ndikon në rezultatin e procedurës.
 19. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë verifikimin negativ të dokumente mbi të cilat pala ankuese e mbështetë kërkesën e tij për pronësi.
 20. Edhe pse vendimi nr. 08-463/28 i leshur nga Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Ri-posedimin e Pronës i Kuvendit Komunal të Pejës, i datës 24 shkurt 1992, ishte gjetur në arkivin e institucionit përkatës, Drejtorati për Kadastër dhe Çështje Pronësore i Komunës së Pejës në Konstatimin e tij nr. 15-463-6520 të datës 26 tetor 2011, kishte refuzuar kërkesën për regjistrimin e pronës në emër të R. R. për shkak të mungesës së bazës ligjore për një kërkesë të tillë.
 21. Sipas nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (GZ e RSFJ-së, nr.6/1980), i aplikueshëm në kohën kur ishte lëshuar vendimi (viti 1992), e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim në bazë të veprimit juridik (sikur që është vendimi në këtë rast) e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në "librin publik " (librin kadastral) apo në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj, neni 33 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (GZ e RSFJ-së, nr. 6/1980)

22. Gjithashtu Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore nr. 03/L-154, neni 115 paragrafi 1 (i aplikueshëm në kohën kur ishte bërë kërkesa për regjistrimin e pronës – viti 2011) thekson si në vijim:
- Për fitimin, ndryshimin e përmbajtjes, bartjen, shuarjen e pronësisë, të drejtës së parablerjes, dhe të drejtave sendore të kufizuara në një paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme si dhe **regjistrimi i ndryshimit juridik në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë.***
23. Fleta poseduese nr. 37 e siguruar *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, e paraqet pronën si të nën-ndarë në ngastra të reja kadastrale me numrat 132/2, 133/1 dhe 138/2 dhe të regjistruar si Pronë Shoqërore në emër të “Koperativa Bujqësore” domethënë vendimi nr. 08-463/28 i lëshuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Ri-posedimin e Pronës nuk ishte ekzekutuar. Kjo do të thotë se pala ankuese nuk e ka fituar të drejtën pronësore pasi që kushtet nga neni 33 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (të RSFJ-së, nr. 6/1980) si dhe kushtet e nenit 115 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (nr. 03/L-154) nuk ishin përmbushur.
24. Bazuar në atë që u tha më lartë, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja në vend që të hidhte poshtë kërkesën e palës ankuese me arsyetimin se binte jashtë fushëveprimit të juridiksionit të tij, ai është dashur të refuzonte kërkesën për mungesë të provave që dëshmonin të drejtën e pronësisë.
25. Pasi që pala ankuese ishte e vetmja e cila kishte paraqitur ankesë dhe gjykata mund të zgjedhë të mos e përkeqësoj gjendjen e palës ankuese në krahasim me vendimin e kundërshtuar (*reformatio in pejus*), vendimi i KKPK-së duhet të vërtetohet.
26. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (a) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, gjyqtar

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it